

MËSIMI 12

1. Kur Satani erdhi për të mashtruar Evën si e fsheu veten ai?
-Brenda një gjarpëri.

2. Pse vendosi Satani ta mashtronte Evën?
-Sepse Satani e urrente Evën.
-Sepse Satani donte ta shkatërronte Evën.

3. A mundohet Satani sot të fus në kurth dhe mashtrojë njerëzit?
-Po.

4. Si mundohet Satani të kapë dhe mashtrojë njerëzit sot?
-Së pari, Satani na flet neve në mendjet tona.
-Së dyti, Satani na flet neve me anë të njerëzve të tjerë.
-Së treti, Satani na flet neve me anë të demonëve.

5. A e dinte Eva që ishte Satani duke biseduar me të?
-Jo.

6. Çfarë i kishte thënë Perëndia Adamit se do t'i ndodhte nëse ata hanin nga Pema e Njohjes të së Mirës dhe të së Keqes?
-Ata do të vdisnin.

7. Çfarë i tha Satani Evës se do t'i ndodhte nëse ata hanin nga Pema e Njohjes të së Mirës dhe të së Keqes?
-Ata nuk do të vdisnin.
-Ata do të bëheshin si Perëndia.

8. Si po e quante Satani Perëndinë?

-Një gënjeshtar.

9. Pasi Adami dhe Eva mëkatuan dhe e panë që ishin lakuriq, çfarë bënë ata?

-Ata bënë rroba me gjethe.

10. Pasi Adami dhe Eva mëkatuan dhe dëgjuan që Perëndia po vinte t'i shikonte, çfarë bënë ata?

-Ata u fshehën nga Perëndia.

11. A është e mundur të fshihesh nga Perëndia?

-Jo. Perëndia është kudo.

12. Kë urren Satani?

-Satani urren Perëndinë dhe të gjithë njerëzit.

13. A do Satani që ti të dëgjosh Fjalën e Perëndisë?

-Jo.

14. Përse nuk do Satani që ti të dëgjosh Fjalën e Perëndisë?

-Sepse Satani i urren të gjithë njerëzit dhe do që ata të shkojnë në Liqenin e Zjarrit të Përrjetshëm.

-Çfarë bëri Perëndia pasi Adami dhe Eva nuk iu bindën Atij?

Le të lexojmë Zanafilla 3:9

9-Atëherë ZOTI Perëndi thirri njeriun dhe i tha: "Ku

je?".

-Pse e thirri Perëndia Adamin?

-A nuk e dinte Perëndia që Adami ishte fshehur?

-Perëndia e dinte që Adami ishte i fshehur?

-Perëndia është kudo.

-Perëndia shikon çdo gjë.

-Asgjë nuk fshihet dot nga Perëndia.

-Pse e thirri Perëndia Adamin?

-Perëndia dontë që Adami të vinte tek Ai dhe të rrëfente mëkatën e tij.

-Perëndia donte që Adami të vinte tek Ai dhe të pranonte që ai nuk i ishte bindur Perëndisë?

-Perëndia donte që Adami të vinte tek Ai dhe të pranonte që ai kishte dëgjuar Satanin?

-Pse mund ta thërrasë Perëndia Adamin?

-Sepse Perëndia e krijoi Adamin.

-Sepse Adami i takonte Perëndisë.

-Sepse Perëndia e krijoi Adamin për t'iu bindur Perëndisë.

-Përse mund ta thërrasë Perëndia të gjithë njerëzit?

-Sepse Perëndia i krijoi të gjithë njerëzit.

-Sepse të gjithë njerëzit i takojnë Perëndisë.
-Sepse Perëndia i krijoi të gjithë njerëzit për t'iu bindur Perëndisë.

-Perëndia nuk ka ndryshuar.
-Perëndia akoma i thërret njerëzit sot.

-Si i thërret Perëndia njerëzit sot?

-Perëndia i thërret njerëzit sot me anë të krijimit.

-Krijimi i Perëndisë tregon që ka një Perëndi, që ky Perëndi e ka bërë gjithçka dhe ky Perëndi do që ne ta dëgjojmë Atë.

-Perëndia gjithashtu i thërret njerëzit me anë të Librit të Tij.

-Libri i Perëndisë është mesazhi i Perëndisë për ty.
- Me Librin e Perëndisë, Perëndia të flet ty.

-Çfarë tha Adami kur Perëndia e thirri atë?

Le të lexojmë Zanafilla 3:10

10-Ai [Adami] u përgjigj: "Dëgjova zërin tënd në kopsht, dhe pata frikë sepse isha lakuriq dhe u fsheha".

-Përse ishin Adami dhe Eva të frikësuar nga Perëndia?
-Sepse ata nuk i ishin bindur Perëndisë.

-Ja një shembull:

-Nëse pronari i një are shkon atje kur hajduti është duke vjedhur misrin e tij, a do të fshihet hajduti?

-Po.

-Nga që Adami dhe Eva mëkatuan dhe nuk iu bindën Perëndisë ata u fshehën nga Perëndia.

-Atëherë çfarë i tha Perëndia Adamit?

Le të lexojmë Zanafilla 3:11

11-Dhe Perëndia i tha: "Kush të tregoi se ishe lakuriq? Mos vallë ke ngrënë nga pema që unë të kisha urdhëruar të mos haje?".

-Pse e pyeti Perëndia Adamin nëse e kishte ngrënë frutin?

-A nuk e dinte Perëndia që Adami e kishte ngrënë frutin?

-Po.

-Pse e pyeti Perëndia Adamin nëse e kishte ngrënë frutin?

-Perëndia donte që Adami të vinte tek Ai dhe të rrëfente mëkatin e tij.

-Perëndia donte që Adami të vinte tek Ai dhe të pranonte që ai nuk i ishte bindur Perëndisë?

-Perëndia donte që Adami të vinte tek Ai dhe të pranonte që ai kishte dëgjuar Satanin.

-Pse mund ta pyeste Perëndia Adamin?

-Sepse Perëndia ishte Ai që e kishte krijuar Adamin.

-Meqenëse Perëndia i krijoi të gjithë njerëzit, Perëndia mund t'i pyesë të gjithë njerëzit.

-Një ditë, Perëndia do t'i pyesë të gjithë njerëzit, dhe të gjithë njerëzve do u duhet t'i përgjigjen Perëndisë.

-Perëndia e pyeti Adamin, dhe si iu përgjigj Adami?

Le të lexojmë Zanafilla 3:12-13

12-Njeriu u përgjigj: "Gruaja që ti më vure pranë më dha nga pema dhe unë e hëngra".

13-Dhe ZOTI Perëndi i tha gruas: "Pse e bëre këtë?". Gruaja u përgjigj: "Gjarpri më mashtroi dhe unë hëngra prej saj".

-Adami ia vuri fajin Evës dhe Eva ia vuri fajin gjarpërit.

-Perëndia e dinte tashmë përgjigjen.

-Asnjë e vërtetë nuk është e fshehur nga Perëndia.

-Çfarë bën dikush kur është kapur duke vjedhur?

-Ai përpiket t'ia vërë fajin dikujt tjetër.

-Ne mund të jemi në gjendje t'ua hedhim të tjerëve duke ia vënë fajin dikujt tjetër.

-Por nuk mund t'ia hedhim Perëndisë duke ia vënë fajin dikujt tjetër.

-Perëndia gjithmonë e di të vërtetën.

-Perëndia gjithmonë i dënon ata që nuk i binden Atij.

-Perëndia gjithmonë i dënon ata që mëkatojnë.

-Së pari, Perëndia dënoi gjarpërin.

Le të lexojmë Zanafilla 3:14

14-Atëherë ZOTI Perëndi i tha gjarpërit: "Me qenë se bërë këtë gjë, qofsh i mallkuar ndër gjithë kafshët dhe tërë bishat e fushave! Ti do të ecësh mbi barkun tënd dhe do të hash pluhur gjithë ditët e jetës sate".

-Si e dënoi Perëndia gjarpërin?

-Si një dënim, gjarpëri duhej të hiqej zvarrë në barkun e tij.

-Pse e dënoi Perëndia gjarpërin?

-Gjarpëri nuk i foli Evës.

-Vetëm Satani i foli Evës.

-Pse e dënoi Perëndia gjarpërin?

-Sepse Perëndia e dënon të gjithë mëkatin.

-Sepse Satani përdori gjarpërin që të mëkatonte.

- Perëndia e dënon të gjithë mëkatin.

-Së dyti, Perëndia dënoi Evën

Le të lexojmë Zanafilla 3:16

16-Gruas [ZOTI Perëndia] i tha: "Unë do të shumëzoj në masë të madhe vuajtjet e tua dhe barrët e tua; me vuajtje do të lindësh fëmijë; dëshirat e tua do të drejtohen ndaj burrit tënd dhe ai do të sundojë mbi ty".

-Si e dënoi Perëndia Evën?

-Kur Eva do të lindte, ajo do të kishte shumë dhimbje.

-Dënimi i Evës ishte dënim për të gjitha gratë.

-Tani, të gjitha gratë lindin me shumë dhimbje.

-Së treti, Perëndia dënoi Adamin.

Le të lexojmë Zanafilla 3:17-19

17-Pastaj [ZOTI Perëndia] i tha Adamit: "Me qenë se dëgjove zërin e gruas sate dhe hëngre nga pema për të cilën të kisha urdhëruar duke thënë: "Mos ha prej saj", toka do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frutin e saj me mund tërë ditët e jetës sate.

18-Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave;

19-Do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh".

-Si e dënoi Perëndia Adamin?

-Adami do ta punonte tokën me shumë djersë dhe të

fitonte pak prodhim.

-Dënimi i Adamit është dënimi për të gjithë burrat.

-Tani, të gjithë burrat e punojnë tokën me shumë djersë dhe fitojnë pak prodhim.

-Si tjetër e dënoi Perëndia Adamin?

-Perëndia e mallkoi të gjithë tokën.

-Cilat janë shenjat që Perëndia e mallkoi tokën?

-Ka shumë ferra dhe barishte të këqija.

-Ka shumë thatësira dhe përmbytje.

-Ka shumë bimë helmuese dhe gjarpërinj.

-Kafshët i hanë njerëzit.

-Njerëzit duhet të punojnë shumë.

-Njerëzit sëmuren.

-Njerëzit vdesin.

-Për shkak se Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, toka u mallkua.

-Për shkak se Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, toka është mbush plot me të këqija.

-Për shkak se Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, të gjithë njerëzit vdesin.

-Dënimi i Perëndisë për mosbindje është vdekja e përjetshme.

-Dënimi i Perëndisë për mëkatin është vdekja e përjetshme.

-Shpejt pasi Perëndia i dënoi Adamin dhe Evën, çfarë premtoi Perëndia se do të bënte?

Le të lexojmë Zanafilla 3:15

15-[ZOTI Perëndia tha] “Dhe unë do të shtie armiqësi midis teje dhe gruas, midis farës sate dhe farës së saj; fara e saj do të shtypë kokën tënde, dhe ti do të plagosësh thembrën e farës së saj”.

-Shpejt pasi Perëndia i dënoi Adamin dhe Evën, Perëndia premtoi që do dërgonte një Shpëtimtar.

-Shpëtimtari do të vinte të luftonte kundër Satanit.

-Satani do ta plagoste Shpëtimtarin, por Shpëtimtari do ta mundte Satanin.

-Shpëtimtari do të vinte për të shpëtuar njerëzit.

-Shpëtimtari do të vinte për të shpëtuar njerëzit nga fuqia e mëkatit.

-Shpëtimtari do të vinte për të shpëtuar njerëzit nga fuqia e vdekjes.

-Shpëtimtari do të vinte për të shpëtuar njerëzit nga fuqia e Satanit.

-Shpëtimtari do të ishte Biri i një virgjëreshe.

-Pse premtoi Perëndia për të dërguar një Shpëtimtar?

-Sepse Perëndia i do shumë të gjithë njerëzit.

-A e meritonin Adami dhe Eva dashurinë e Perëndisë?

-Jo.

-Përse nuk e meritonin Adami dhe Eva dashurinë e Perëndisë?

-Sepse ata nuk iu bindën Perëndisë dhe dëgjuan Satanin.

-Çfarë meritonte mosbindja e Adamit dhe Evës?

-Mosbindja e tyre meritonte vdekjen e përjetshme.

-Mosbindja e Adamit dhe Evës meritonte vdekjen.

-Por Perëndia premtoi që do dërgonte një Shpëtimtar për t'i shpëtuar ata.

-Ja një shembull:

-Një burrë që po vdes vjen në shtëpinë tënde.

-Ti ble mjekim dhe ushqim për të.

-Ai qëndron shumë ditë me ty.

-Më në fund, ai shërohet.

-Përpara se ai burrë të largohet, ai të vjedh lopën ty.

-Më vonë, ky burrë kthehet, dhe përsëri është gati të vdes.

-Ti përsëri ble mjekim dhe ushqim për të.

-Përsëri, ai shërohet.

-Ai burrë vodhi lopën tënde, dhe meriton dënim.

-Por, ti e ndihmove të shërohej edhe një herë.

- Mosbindja e Adamit dhe Evës meritonte vdekjen.
- Por Perëndia premtoi të dërgonte një Shpëtimtar për t'i shpëtuar ata.

Le të lexojmë Zanafilla 3:20

20-Dhe burri i vuri gruas së tij emrin Evë, sepse ajo qe nëna e tërë të gjallëve.

- Eva është gruaja e parë dhe nëna e të gjithë njerëzve.
- Adami është burri i parë dhe babai i të gjithë njerëzve.
- Të gjithë njerëzit erdhën nga Adami dhe Eva.
- Satani mendonte se ishte në gjendje për ta mundur Perëndinë duke shkatërruar Adamin dhe Evën.
- Por Perëndia premtoi që do të dërgonte një Shpëtimtar që do ta mundte Satanin.